



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:001398

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05728293

P.nr.2/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpuntoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurve P... S., L... S...dhe H... S.. nga fshati Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kanosje nga neni 181 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1900/2023 të datës 25.12.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 24.04.2024, mori këtë, ndërsa me shkrim me datë 14.05.2024 përpiloi:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve:

1.P... S., nga babai Sh..., nëna Xh..., e gjinisë A..., i lindur me datë ..., në Gjilan, me vendbanim në fshatin L... i E..., komuna Gjilan, i martuar, babë i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

2.L.... S...., nga babai Sh...,nëna Xh..., e gjinisë A..., i lindur me datë..., në Gjilan, me vendbanim në fshatin ..., i martuar, ka të kryer shkollëne mesme, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

3.H... S...., nga babai S..., nëna F..., e gjinisë M..., i lindur me datë, në Gjilan, me vendbanim në fshatin ..., i martuar, babë i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

S E P S E

Me datë 03.12.2023, rreth orës 18:00, në Gjilan, të pandehurit në bashkëkryerje, e kanë kanosur seriozisht të dëmtuarin Jeton Maksuti, në atë mënyrë që: i dëmtuari i kishte shitur vetura dëshmitarit dhe se i njëjti i kishte mbetur borxh, për çka i dëmtuari ka kërkuar nga të pandehurit që të bisedojnë me n që t'ia kthej borxhin, mirëpo të njëjtit nuk kanë mundur të realizojnë këtë dhe se pas mosmarrëveshjes mes vete, i pandehuri Hajriz i ka shkruar mesazh duke i thënë: „, ni sen dije qe me neve nbela je pi sontit u kry ky muhabet a pi sontit mati koqet mire’’, i pandehuri Liridon i ka shkruar: „, o kena mu pa kismet se paret skan met bo zgjidhje ma die pi kti momentit, veq fol ku po zatetmi e krym ket pun qetasht’’ met parin shimi kismet mos ta nin e kqyrmi kujna intereson se per ty jom hi ama veq ni sen dije qe ski pun me gzima me bekima’’, ndërsa i pandehuri Përparim, para rreth një muaj më parë, i kishte dërguar një foto ku në shpinë kishte një armë të llojit „, çka të pandehurit me veprimet e tyre, tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë;

- Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, **kanosja, nga neni 181 paragrafi 2, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit e lartcekur:

I GJYKON

Me Dënim me gjobë në shumë prej nga **300 (treqindë euro)€**, për secilin veç e veç të cilat dënime janë të obliguar ti paguajnë në 2(dy) këste mujore nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit refuzojnë të paguajë dënimin me gjobë ose nuk janë në gjendje ta paguajnë atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarve do ti zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€(njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej nga 20€, si dhe nga 20 euro secili veç e veç per kompensimin e viktimave te krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1900/2023 të datës 25.12.2023, ndaj të pandehurve për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kanosje nga neni 181 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 24.04.2024, kanë qenë prezent prokurorja e shtetit, të pandehurit, e lartcekur ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, të pandehurit janë deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, për të cilin pranim është pajtuar edhe prokurorja e shtetit dhe gjykatës i ka propozuar që të pandehurit ti shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin kanë pranuar fajësinë e të pandehurve për kryerjen e veprës penale konform nenit 242 paragrafi 1 i KPRK-së, për të cilën akuzohen, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se të pandehurit nuk ka qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit, kanë kryer veprën penale, bashkëkryerje kanosje nga neni 181 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës se të pandehurit, e ka shpallur fajtor të pandehurit, të cilët kanë kryer veprën penale bashkëkryerje kanosje nga neni 181 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtit janë dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se të njëjtit e kanë pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi me gjobë për secilin veç e veç ne shumen prej nga 300(treqindë) euro, të cilin dënim janë të obliguar ta paguajnë në 2(dy) këste mujore, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Mirëpo nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgimi, ose në

mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim është fakti se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, të pandehurit janë penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, i kanë premtuar gjykatës se veprimet e tilla nuk do ti përsërisin. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese gjykata ka marr parasysh veprën e kryer dhe peshën e veprës penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore të saj.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se dënimi me gjobë ne shumën prej nga 300(treqindë)euro,konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurës, gjykata, duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit t'i detyrojë për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 2/2024, më 14.05.2024

BashkpunëtorëProfesionale,
Vlora Selmani-Rahimi

Gjyqtari,
Veli KRYEZIU

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.